

Një Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Prill 2024

Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.



Përmbajtja

- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet
- Tregues Monetar
- Renditja e Shqipërisë sipas:
 - *Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit*
 - *Indeksit të Lirisë ekonomike*
 - *Indeksit Global të Inovacionit*
 - *Indeksit të Kompleksitetit Ekonomik*
 - *Indeksit të Gadishmërisë Teknologjike*

Ecuria e Treguesve Kryesore Makroekonomikë

- ❖ *Përgjatë vitit 2023, ekonomia u rrit me 3,44% krahasuar me vitin e kaluar, bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT;*
- ❖ *Inflacioni mesatar përgjatë vitit 2023 arriti 4,8% duke qëndruar mbi objektivin e Bankës Qendrore prej 3%.*
- ❖ *Flukset e IHD-ve gjatë vitit 2023 u rritën me 8,7% krahasuar me vitin 2022, ndërsa stoku i IHD-ve u rrit me 20,3%. Gjatë vitit 2023, flukset e IHD-ve arritën 1.492 mln Euro, 54% e të cilave janë fitimet e riinvestuara.*
- ❖ *Hollanda është vendi me fluksin më të lartë të IHD-ve për vitin 2023, ndjekur nga Italia dhe Turqia. Hollanda udhëheq stokun e IHD-ve, ndjekur nga Zvicra.*
- ❖ *Në 2023, norma zyrtare e papunësisë regjistroi shifrën 10,7% me rënie 0,2 p.p krahasuar me një vit më parë.*
- ❖ *Gjatë 2023 vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kosova (8,3 %), Greqia (13,1 %), Kina (2,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (21,0 %), Gjermania (5,2 %), SHBA (32,3 %), etj.*




Vlerësimi sipas Indekseve botërore

- ❖ Bazuar në Indeksin e perceptimit të korrupsionit, Shqipëria renditet e **98/180** në rang botëror, duke përmirësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar me tre vende. Mali i Zi ka renditjen më të mirë nga të gjithë gjashtë vendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor (63/180).
- ❖ Shqipëria vlerësohet Relativisht e Lirë bazuar në Indeksin e Lirisë Ekonomike i cili e rendit ekonominë e Shqipërisë të 48-ën më të lirë mes 177 vende.
- ❖ Shqipëria renditet e 83-ta në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2023, e fundit në rajon. Serbia kryeson rajonin në Inovacion.
- ❖ Shqipëria renditet e 76a nga 133 vende përsa i përket Indeksit të Kompleksitetit Ekonomik.
- ❖ **Referuar Indeksit të Gatishmërisë së Teknologjisë Kufitare të Avancuara, Shqipëria** përfshihet në grupin e vendeve që vlerësohen **poshtë-mesatares**, në dallim nga vendet e tjera të BP të cilat klasifikohen mbi-mesataren.


Ecuria e Rritjes Ekonomike

Rritja Ekonomike, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019 dhe ra përgjatë vitit 2020 me -3,3%, rënie më e vogël krahasuar me parashikimet fillestare, si rezultat i pandemisë COVID19. Gjatë 2023 rritja vlerësohet 3,4% bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT ndërkohë BB vlerëson rritje 2,6% për BP.

RER, Banka Botërore vjeshtë 2023




Bazuar në vlerësimet e BB, gjatë vitit 2023, Mali i Zi vlerësohet me rritjen më të lartë në BP prej 6%, e ndjekur nga Shqipëria dhe Kosova me respektivisht 3,3% dhe 3,1%. Rritja më e ulët vlerësohen në Maqedoninë e Veriut me vetëm 1.0%. Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina parashikohet të kenë rritje të qëndrueshme deri në vitin 2026 deri në 4%; ndërkohë Shqipëria vlerësohet me rritje më të moderuar deri në 3,5%.




Ecuria e Rritjes Ekonomike

Vlerësimi rritjes Ekonomike Shqipëria 2023



Vlerësimi Rritja ekonomike Shqipëria 2024 - 2026




Bazuar në të dhënat paraprake të INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto gjatë vitit 2023 në Shqipëri u rrit me 3,4%.

BB dhe FMN japin një parashikim më të ulët të rritjes ekonomike për periudhën 2024 - 2026, krahasuar me parashikimet e Qeverisë Shqiptare.



Rritja Ekonomike sipas Tremujorëve




PBB në T-IV 2023 vlerësohet me rritje prej 3,8%, kundrejt T-IV 2022. Kontribut pozitiv kanë dhënë degët: Ndërtimi me +1,28p.p, Administrata Publike, Arsimi dhe Shëndetësia me +1,01p.p, Aktivitete Profesionale dhe Shërbime Administrative me +0.66p.p, Aktivitete të Pasurive të Paluajtshme me +0,58p.p, Arte, Argëtim dhe Çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi me +0,46p.p, Informacioni dhe Komunikacioni me +0,28p.p, Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit me +0,15p.p, Tregti,Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor me +0,07p.p. Negativisht kontriboi grupi: Bujqësi, Pyje dhe Peshkim me -0,72p.p, Industri, Energji dhe Uji me -0,23p.p.


E Ardhura për Frymë

Për vitin 2022, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **6.810 USD** në vlerë korrente, më lart se një vit më parë.

Produkti i Brendshëm Bruto për frymë (USD/frymë)




2022 Të ardhurat për frymë



Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Tregtia e jashtme, miliardë lekë




Gjatë vitit 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 440 mld lekë, duke u ulur me -9,5%, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 873 mld lekë, duke u ulur me -8,2%, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën 432 mld lekë, duke u ulur me -6,7%, krahasuar me vitin 2022.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve ra në 50,5% nga 51,3% në 2022.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Importe në vite, milionë lekë




Gjatë vitit 2023, importet janë ulur me -8,2%, krahasuar me vitin 2022.

Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -7,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,8 pikë përqindje, etj.

Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,7 pikë përqindje.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Eksporte në vite, në milionë lekë



Eksportet, gjatë këtij viti janë ulur me -9,5 %, krahasuar me një vit më parë.

Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,8 pikë përqindje, etj.


Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: “Ushqime, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje.



Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave gjatë 2023 dominohet nga Ushqime, pije, duhan, e cila ka ardhur në rritje përgjatë viteve, Materiale ndërtimi dhe minerale si edhe Produkte kimike dhe plastike.


Importet sipas produkteve





Eksportet e Mallrave

Eksporte sipas produkteve




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre të njëjtë me vitin e kaluar.

Ndërkohë, në vështrim të ecurisë nga 2016- 2023, vihet re konsolidim i uljes së përqindjes ndaj totalit të eksporteve të grupit “Tekstile dhe këpucë” dhe një rritje të eksporteve në “Materiale ndërtimi dhe minerale” dhe “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike.

Qarkullimi i Mallrave-sipas vendeve partnere

Eksporte sipas vendeve partnere, në milion lekë




Shkëmbimet tregtare, për vitin 2023, me vendet e BE-së zënë 57,9 % të gjithë tregtisë.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,8 % të eksporteve gjithsej Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,2 %), Kina (7,9 %), Turqia (6,8 %) dhe Greqia (6,5 %).

Gjatë këtij viti vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,2 %), Gjermania (27,7 %), Spanja (19,1 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kosova (8,3 %), Greqia (13,1 %), Kina (2,7 %), etj.

Qarkullimi i Mallrave sipas vendeve partnere

Importe sipas vendeve partnere, në milionë lekë





Në periudhën Janar – Dhjetor 2023 importet nga vendet e BE-së zënë 50,9% të importeve gjithsej.

Gjatë këtij viti, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (5,9%), Turqia (26,2%), Greqia (23,6%), etj.

Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (21,0%), Gjermania (5,2%), SHBA (32,3%), etj.

Eksportet në Shërbime Konteksti Rajonal




Edhe gjatë vitit 2022, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve.

Ndërkohë Shqipëria renditet e fundit në rajon përsa i përket eksportit në Shërbime TIK.

Importe në udhëtime Konteksti Rajonal

Importet në udhëtime (% ndaj Importeve në Shërbime)




Shqipëria renditet e para në rajon përsa i përket % së inporteve në udhëtime ndaj importit të shërbimeve. Gjatë 2022 ky tregues ishte 73,7% e totalit të importit të shërbimeve. Vendi i dytë në radhë është Kosova me 39,5% e ndjekur nga Bosnia dhe Hercegovina me 31,5%.



Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2023 është 4,8 % nga 6,7 % që ishte në vitin 2022.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendenca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji nëntor 2021, ku inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH dhe arriti kulmin në muajin tetor 2022, me 8,3%. Pavarësisht tendencës rënëse inflacioni vazhdon të jetë mbi objektivin e BSH prej 3%.



Kursi i këmbimit


Ecuria e kursit të këmbimit, USD/ALL, EURO/ALL




Përgjatë vitit 2023, kursi mesatar i këmbimit lekë/Euro ishte 108,8 ndërsa lekë/USD ishte 100,65;

Kredia për ekonominë

Kredia për ekonominë, në milionë lekë




Kredia e re per ekonomine, 2023 (mln lekë)



Kredia totale për ekonominë arriti në 744 miliardë lekë në dhjetor 2023 ndërsa shumica e kredisë së re gjatë vitit 2023 shkoi në tregtinë me shumicë dhe pakicë, Ndërtimi dhe Industria Përpunuese.

Forca e Punës


Norma e papunësisë



Gjatë vitit 2023, bazuar në të dhëna paraprake shkalla e papunësisë u ul me **0,2 p.p** krahasuar me një vit më parë.

Paga Mesatare sipas Sektorëve (Në Lekë)

Paga mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve kryesore



Gjatë 2023, bazuar në të dhëna paraprake, pagat më të larta janë regjistruar në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”, trend i konsoliduar tashmë.


Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.

Gjatë 2023 vihet re rritje e pagës mesatare të raportuar në të gjithë sektorët, (mesatarisht 14%). Rritja më e lartë regjistrohet tek aktivitetet TIK, Administrata Publike dhe Bujqësia.



Paga Mesatare dhe Paga minimale

Paga bruto në lekë



Paga mesatare gjatë 2023 (të dhëna paraprake) është raportuar në **70.530 lekë** me rritje **14%** kundrejt një viti më parë.


Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **65.554 lekë** me një rritje **12,6%** krahasuar me një vit më parë; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte **81.898 lekë**, me një rritje **16,9%** krahasuar me një vit më parë.

Paga minimale u rrit në 40.000 lekë nga T-II 2023.

Shënim: Të dhënat janë mesatare të shifrave tremujore publikuar nga INSTAT

Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor


Pagat mesatare për një të punësuar në Ballkanin Perëndimor (EURO)




Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është regjistruar në Malin e Zi, e ndjekur nga Serbia dhe Bosnjë dhe Hercegovina, ndërkohë Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon së bashku me Kosovën.

Vlera e Shtuar për Punonjës në Ballkanin Perëndimor

Vlera e shtuar/punonjës, Industria (përfshi Ndërtimin) (USD)



Vlera e shtuar/punonjës, Shërbime (USD)



Shqipëria rendit e fundit në rajon përsa i përket produktivitetit të punës në Shërbime (11.844\$) dhe Bujqësi (5.139\$) dhe e parafundit përsa i përket Industrisë (përfshi ndërtimin) (9.756\$).


Mal i Zi kryeson produktivitetin në Bujqësi me diferencë nga vendet e tjera të BP (19.384\$), dhe Industri (18.624\$); ndërsa Bosnja dhe Hercegovina kryeson Produktivitetin në Shërbime (18.432\$)

Vlera e shtuar/punonjës Bujqësia, pyjet, Peshkimi (USD)



Investimet Publike, Private dhe IHD



Investimet Publike, Formimi Bruto I Kapitalit Fiks and IHD



Formimi bruto i kapitalit fiks arriti 24% gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2023, Investimet publike arritën 5,9% të PBB, kurse Investimet e Huaja Direkte 6,3% të PBB. Remitancat në 2023 arritën sa 4,4% e PBB.



Investimet Private në Ekonomi



Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2022, investimet private u rritën me 8,9%, dhe 53% e Investimeve vijnë nga prodhuesit e të mirave, në dallim nga një vit më parë ku shumica e investimeve vinte nga prodhuesit e shërbimeve.

Shumica e Investimeve gjatë vitit 2021, kanë qenë investime në Makineri dhe Pajisje, 25,3% e totalit, në rënie krahasuar me një vit më parë prej 6p.p.

Investimet e Huaja Direkte




Gjatë vitit 2023, fluksi hyrës i IHD u rrit me 8,7% krahasuar me një vit më parë. Edhe pse flukset hyrëse të IHD-ve kanë qenë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD-ve në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri në T-IV 2019 dhe ka filluar sërish rimëkëmbjen gjatë T-II 2020. Gjatë vitit 2023, flukset e IHD arritën 1.492 mln Euro, 54% e të cilave janë fitimet e riinvestuara të cilat kanë pësuar rritje duke filluar nga viti 2017.


Ndërkohë, gjatë vitit 2023, stoku i IHD-ve u rrit me 20% krahasuar me një vit më parë duke arritur 13.309 milionë Euro.

Investimet e Huaja Direkte

Investimet e Huaja Direkte, në % PBB



IHD stoku si % ndaj PBB




Flukset e Investimeve të Huaja në Shqipëri ruajtën të njëjtin trend edhe përgjatë vitit 2023, 6,7% të PBB, ndërsa stoku IHD arriti në 63% të PBB.




Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD ne vite (në mln EURO)



Stoku IHD, sipas vendit të origjinës, në milionë Euro




Hollanda është vendi me fluksin më të lartë të IHD-ve për vitin 2023, 300 milionë Euro e ndjekur nga Italia me 203 milionë Euro dhe Turqia me 179 milionë Euro.

Ndërkohë, në T-IV 2023, Hollanda udhëheq stokun e IHD-ve, duke arritur në 2.235 milionë Euro e ndjekur nga Zvicra me 2.088 mln Euro.



Investimet e Huaja Direkte


Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, në milionë Euro



Gjatë vitit 2023, sektori më tërheqës për IHD-të vazhdon të jetë Aktivite të Pasurive të Paluajtshme (325 mln Euro, 11,7% më shumë se 2022) e ndjekur nga Industria Nxjerrëse (270 mln Euro) dhe Aktivite Financiare dhe të Sigurimit (239 mln Euro).

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Fluksi IHD Ballkani Perëndimor, % PBB




Shqipëria renditet e treta në rajon për IHD me 7,6% të PBB në 2022, ndërkohë që Mali i Zi vazhdon të udhëheqë rajonin përsa i përket flukseve hyrëse të IHD-ve të cilat në 2022 ishin sa 14% e PBB e ndjekur nga Kosova e cila ka përmirësuar pozicionin e saj në rajon me 8,1% e PBB për vitin 2022.

Rritje më të madhe ka Kosova me 2,8p.p dhe Mal i Zi me 2,1p.p krahasuar me një vit më parë.



Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Fluksi IHD Ballkani Perëndimor, milionë USD



Flukset hyrëse të IHD-ve në Serbi ishin **4,6 miliardë USD** për vitin 2022, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e **1,4 miliardë USD**

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon për vitin 2022 është Bosnja dhe Hercegovina me 798 milionë USD.

Kosova ka përjetuar rritjen më të lartë të flukseve të IHD-ve me 52,5% e ndjekur nga Mal i Zi dhe Maqedonia e Veriut me respektivisht 25,8% dhe 22,7%.



Stoku Dhe Profili i Ndërmarrjeve

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrje të vogla me 1-9 të punësuar

Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve, nuk përfshin aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare


Treguesit	Numri i ndërmarrjeve						
Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	102,965	101,595	100,876	96,924	95,558	97,022	106,132
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	4,413	4,839	5,246	5,736	5,674	5,608	5,842
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	996	1,077	1,147	1,251	1,173	1,227	1,306
NVM (1-249 të punësuar)	108,373	107,511	107,269	103,911	102,405	103,857	113,279
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	152	166	181	179	169	174	181
Gjithsej	108,526	107,677	107,450	104,090	102,574	104,031	113,460

Treguesit	Numri i të punësuarve						
Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	194,015	192,817	194,867	196,403	186,400	191,250	206,598
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	87,796	95,574	102,950	114,451	111,347	111,318	115,007
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	98,491	107,171	113,911	122,330	114,767	121,002	128,026
NVM (1-249 të punësuar)	380,302	395,563	411,727	433,184	412,514	423,570	449,631
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	89,363	97,350	103,979	97,669	91,472	95,669	98,311
Gjithsej	469,665	492,913	515,706	530,853	503,986	519,240	547,942



Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

Indeksi i Perceptimit të korrupsionit, renditja 180 vende




Shqipëria renditet e **98/180** në rang botëror, duke përmirësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar me tre vende. Shqipëria e ka rritur vlerësimin e indeksit nga nga 36 një vit më parë, në 37 për vitin 2023.

Mali i Zi ka renditjen më të mirë nga të gjitha gjashtë vendet ne rajonin e Ballkanit Perëndimor (63/180), i ndjekur nga Maqedonia e Veriut (76/180) dhe Kosova 83/180).



Liria Ekonomike

Liria Ekonomike, 177 vende të vlerësuara



Shqipëria vlerësohet me një indeks 64,8 të lirisë ekonomike duke e bërë ekonominë e saj të 48-ën më të lirë në Indeksin e Lirisë Ekonomike 2024.


Vlerësimi i saj ka rënë me 0.5 pikë nga viti i kaluar dhe Shqipëria renditet e 27-ta nga 44 vende në rajonin e Evropës.

Shqipëria vlerësohet Relativisht e Lirë.

Rezultatet për Indeksin e Lirisë Ekonomike bazohen përgjithësisht në të dhënat për periudhën që mbulon gjysmën e dytë të vitit t-2 deri në gjysmën e parë të vitit t-1


Treguesit e Lirisë Ekonomike - Indeksi në vite

Sundimi i Ligjit, Indeksi




Sundimi i ligjit vlerësohet i dobët në Shqipëri. E drejta mbi pronën vlerësohet mbi mesatare botërore; Efektiviteti juridik është mbi mesataren botërore; ndërsa integriteti i qeverisjes vlerësohet nën mesataren botërore.

Efektiviteti Rregullator




Mjedisi i përgjithshëm rregullator është relativisht i mirë institucionalizuar, por mungon efikasiteti. Rezultati i lirisë së biznesit është mbi mesataren botërore; rezultati i lirisë së punës është nën mesataren botërore; dhe rezultati i lirisë monetare është shumë mbi mesataren botërore.

Treguesit e Lirisë Ekonomike - Indeksi në vite




Shkalla më e lartë e tatimit mbi të ardhurat individuale është 23%, dhe shkalla më e lartë e tatimit mbi korporatat është 15%. Barra tatimore është e barabartë me 19% të PBB-së. Mesatarja e shpenzimeve trevjeçare të qeverisë dhe bilancit buxhetor janë përkatësisht 31,7% dhe -5.0% të PBB-së. Borxhi publik arrin në 65,5% të PBB-së.



Norma mesatare e tarifave tregtare është 3,7% dhe janë në fuqi më shumë se 190 masa jotarifore. Në përgjithësi, hapja ndaj investimeve të huaja është mbi mesataren botërore, por ligjet e investimeve nuk kanë transparencë. Sektori bankar është relativisht i mirëkapitalizuar pavarësisht mjedisit sfidues.

Indeksi Global i Inovacionit - Renditja në nivel global

Indeksi Global i Inovacionit (Renditja 132 ekonomi)




Shqipëria renditet e 83-ta në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2023, e fundit në rajon.

Serbia kryeson rajonin në Inovacion sipas raportit më të fundit të GII.

Indeksi Global i Inovacionit - Renditja 2023


Indeksi Global i Inovacionit, Rënditja 132 ekonomitë për 2023



Shqipëria renditet ulët në Kërkim dhe Kapital Njerëzor, Sofistikim i Tregut dhe Njohuri dhe Prodhim Teknologjik dhe Prodhim Kreativ.

Më mirë Shqipëria renditet në Sofistikimin e Biznesit, Infrastruktura dhe Institucione.

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik - Renditja




Shqipëria renditet e 76a përta i përket Indeksit të Kompleksitetit Ekonomik, ndërkohë Bosnja dhe Hercegovina renditet e 32a dhe Serbia e 37a.

Në vend të parë renditet Japonia, kurse në vend të fundit (133) renditet Liberia.

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik - Rendit vendet bazuar në sa e larmishme dhe komplekse është shporta e tyre e eksportit.

Indeksi i Gadishmërisë së Teknologjive - Renditja



Shqipëria përfshihet në grupin e vendeve që vlerësohen **poshtë-mesatares**, në dallim nga vendet e tjera të BP të cilat klasifikohen mbi-mesataren.

Më mirë renditet në TIK dhe më poshtë në K&Zh.

	Vlerësimi
SRB	mbi-mesatare
MNE	mbi-mesatare
MKD	mbi-mesatare
BiH	mbi-mesatare
ALB	poshtë-mesatare

Indeksi i gatishmërisë së teknologjisë kufitare të avanzuara tregon se sa të përgatitura janë vendet për të adoptuar dhe përshtatur teknologjitë kufitare të avanzuara. Ai llogaritet nga UNCTAD jep rezultate për 166 ekonomi të cilat klasifikohen në 4 grupe: e ulët, poshtë-mesatares, sipër-mesatare dhe i lartë.